



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçante



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201400323/3

Tiranë ___/___/2014

Lënda: Rekomandojmë shpejtimin e procedurës së gjyimit të çështjes penale Nr.791 akti, datë 03.03.2014 me të gjykuar **A. S.** nga Tirana.

Drejtuar : **Z. Alaudin MALAJ**
Kryetar i Gjykatës së Apelit

TIRANË

I nderuar Z. Kryetar,

Në ankesën e tij datë 26.02.2014 drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi U. S. nga Tirana ankohet ndaj një gjykimi penal të padrejtë të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë në lidhje me një kërkesë për ndryshimin e masës mjeksore për djalin e tij **A. S.** nga mjekim i detyruar në një institucion mjeksor , në mjekim të detyruar abulator në bazë të nenit 46 të K.Penal.

Nga ankesa rezulton se me vendimin gjyqësor Nr.15 akti, datë 03.02.2014 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur vazhdimin e masës mjeksore të mjekimit të detyruar në një institucion mjeksor të dhënë nga Gjykata me datën 25.03.2009 ndaj shtetasit A. S.

Ankuesi U. S. nga ana e tij pretendon se ky gjykim është i padrejtë pasi djali i tij qëndron në kundërshtim me ligjin në Spitalin e Burgut Tiranë për 5 vjet, ku është mjekuar me ilaçe të ndryshme dhe ka patur përmirësim të gjendjes shëndetësore dhe ky fakt provohet me aktin e ekspertimit datë 16.12.2013 të ekspertëve psiatriko-ligjor N. Sh. dhe S. L. ku përcaktohet se:” Bazuar në gjendjen aktuale psiqike dhe rezikshmërinë shoqërore prezente për shkak të sëmundjes mendore nuk është e nevojshme masa mjeksore,”Mjekim i detyruar në një institucion psiqik”, pranë QSB Tiranë, fakt ky që nuk është marrë në konsiderat nga gjykata.

Ankuesi pretendon se djali i tij A. S. mbahet padrejtësisht në burg pasi ai është i sëmurë mendor dhe si i tillë ai duhet të trajtohet me shërbim shëndetësor konformë përcaktimit të nenit 28 të Ligjit nr.44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, dhe trajtimi i personave në institucionet mjeksore të posaçme është i njëjtë me trajtimin e pacientëve të tjerë me ç’rregullime të shëndetit mendor, duke kërkuar me këtë rast ndihmën dhe ndërhyrjen e institucionit tonë për shpejtimin e këtij gjykimi dhe zgjidhjen e problemit në bazë të ligjit, pasi një institucion i tillë në vendin tonë nuk është ndërtuar akoma.

Pra në vendin tonë nuk ka një institucion mjeksor të veçantë ku mund të trajtohen pesonat me ç’rregullime të shëndetit mendor prandaj ai ka kërkuar

ndryshimin e masës mjeksore, dhe dhënien e masës mjeksore“Për mjekim të detyruar ambulator”.

Mungesa e një institucioni të tillë dhe mbajtja në Spitalin e Burgut Tiranë e kërkuarit A. S. përbën rrezik për jetën e tij dhe organet proceduese dhe nga gjykata me vendimin e saj nuk duhet të mbrohet nga shteti pasi gabimet e lejuara në rastin konkret nuk duhet të kompensohen në dëm të drejtave ligjore të shtetasit A. S. Ky qëndrim është mbajtur i qartë dhe i prerë edhe nga jurisprudenca e Gjykata Kushtetuese në vendin tonë në vendimin e saj Nr.20 datë 01.06.2011 me kërkuar A. Xh,f.3.

Mbajtja e këtyre personave në burgje vjen në kundërshtim me nenin 14 të KEDNJ pasi të sëmurët mendor nuk mund të diskriminohen për shkak të statusit të tyre si persona me probleme të shëndetit mendor.

Duke ju referuar dokumentit ”Mbi Rregulat Europiane të Burgut, miratuar nga Këshilli i Europës dhe deleguar për zbatim me rekomandimin 87/3 të Këshillit të Ministrave të vendeve anëtare, nëpërmjet shumë rregullime të këtij dokumenti kemi veçuar pikën 100.1, ku përcaktohet se:” Personat që konstatohen me probelme të shëndetit mendor nuk mund të mbahen në burg, por ato duhet të dërgohen sa më shpejtë të jetë e mundur nga burgjet në vende të përshtatshme për këtë kategori personash”.

Kjo shkelje e të të drejtave të njeriut vjen në kundërshtim me nenin 15 të Kushtetutës së RSH, ku parashikohet se:”Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Organet e pushtetit publikë në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe të kotribojnë për realizimin e tyre”.

Ndodhur problemi në këto rrethana dhe bazuar në kërkesat e nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se:”Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, nga administrata publike dhe neni 25 i Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se:”Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendime të formës së prerë, dhe procedurat gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë gjykatës në marrjen e vendimit”.

Për sa sipër, Ju

R E K O M A N D O J M Ë :

1.Shpejtimin e procedurave të gjykimit të çështjes penale Nr.791 akti, datë 03.03.2014 me të gjykuar A. S.

2.Për zbatimin e këtij rekomandimi dhe masat e marra nga ana juaj lutemi të njoftohemi me shkrim brenda 30 ditëve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI